

Njoftim për përqendrim me të cilin Aricoma Digital s.r.o. Republika Çeke do të fitojë kontroll mbi pasuri të caktuara të Eviden Çeshka Republika s.r.o., Republika Çeke

(lënda nr. 08-152/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 22.10.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Grupi KKCG, përmes shoqërisë së tij të varur Aricoma Digital s.r.o. me seli në Vinohradaska 1511/230, 100 00 Pragë 10, Republika Çeke, synon të fitojë kontroll të plotë indirekt mbi pasuri të caktuara të Eviden Çeshka Republika s.r.o me seli në Pragë 4 – Nusle, Doudlebska 1699/5, Republika Çeke.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

Aricoma Digital s.r.o. është pjesë e Grupit Aricoma dhe fokusohet në digjitalizimin e shërbimeve qeveritare, duke aplikuar njohuritë e saj mbi proceset dhe legjislacionin, si dhe njohuritë më të fundit nga fusha e zhvillimit të softuerit, sigurisë kibernetike, mbrojtjes së të dhënave ose inteligjencës artificiale. Aricoma i përket Grupit KKCG.

Grupi KKCG investon në fusha të ndryshme biznesi, përfshirë lotaritë dhe lojërat e fatit, energjetikën, patundshmëritë dhe teknologjitë informatike.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi KKCG është i pranishëm në tregun e operimit me terminale për video llotari dhe teknologji informatike përmes shoqërive vijuese:

- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit KASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MAKEDONIJA SHPK Shkup, me veprimtari parësore - veprimtari të bixhozit dhe basteve;
- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit Video lotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë - KASINOS AUSTRIA SHPK Shkup, me veprimtari parësore - veprimtari të bixhozit dhe basteve;
- Shoqëria për teknologji informatike AVENGA SHPKNJP Shkup, me veprimtari parësore - programim kompjuterik; dhe
- Shoqëria për arsim kompjuterik dhe zhvillim të inovacioneve AVENGA Academy SHPKNJP Shkup, me veprimtari parësore - arsim tjetër i papërmendur diku tjetër;
- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime Musala Soft SHPKNJP Shkup - me veprimtari parësore - programim kompjuterik.

Transaksioni i referohet fitimit të kontrollit të plotë mbi pasuri të caktuara të Eviden Çeshka Republika s.r.o. me seli në Pragë 4 – Nusle, Doudlebska 1699/5, kod postar 140 00, veprimtaria parësore e së cilës janë shërbimet IT, shërbimet komplekse të sigurisë kibernetike dhe shërbimet cloud.

Sipas parashtruesit të njoftimit, tregu relevant për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohet si tregu i shërbimeve IT në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të hetimit preliminar, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni u bën thirrje palëve të treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

30.10.2025

Shkup